



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1** "Duarkryq" gjatë vrasjes së portugezit, kush janë punonjësi i Burgut të Fierit dhe 2 policët që punonin si bodyguard te 'Principote' (EMRAT)
- 2** Vrasja e turistit portugez në Ksamil/ Arrestohen 11 persona! Në kërkim 2 të tjerë, mes tyre edhe pronari në hije i 'Principotes'! Kush është ndihmësi kryesor i autorit Sokrat Vata, i riu u dhunua edhe nga kamariertë (EMRAT)
- 3** Firmoset udhëzimi për artin publik, asnjë monument apo instalacion nuk do të vendoset pa vlerësim profesional, Gondhja: Fund ndërhyrjeve amatore pa sens artistik!
- 4** Tragjedi në Ksamil, punonjësi i 'Principotes' vret turistin portugez me thikë brenda beach-barit Sherni për një vajzë, autori kapet në bagazhin e makinës së dy turqve! Në pranga edhe 10 të tjerë (EMRAT + VIDEO)
- 5** Vrasja e turistit portugez në Ksamil, zbardhet dëshmia e dy turqve për Sokrat Vatin: E paguanim si bodigard dhe shoqërues personal (EMRAT)

Kronikë

Atentati i dështuar në Elbasan, autori: U hakmora për vëllanë e plagosur! Shënjestra: Kemi 15 vite në të njëjtën lagje, jetojmë normalisht

Detaje të reja janë mësuar nga atentati i dështuar i një dite më parë në një lokal në Elbasan. Autori ka deklaruar se e kreu sulmin për hakmarrje ndaj personit që, sipas tij, kishte plagosur vëllain e tij vite më parë. Ndërkohë, shënjestra e atentatit pretendon se marrëdhëniet mes tyre ishin normalizuar. Fatmirësisht ngjarja nuk pati viktima pasi arma nuk funksionoi në momentin e sulmit.

Atentati i dështuar në Elbasan, autori: U hakmora për vëllanë e plagos

Report TV



Watch on

Keti Banushi

16 Gusht, 12:07 | Përditësimi: 16 Gusht, 14:07

Share

Post

WhatsApp

A A

"E bëra për t'u hakmarrë për vëllain tim, të cilin e ka plagosur 15 vite më parë". Kështu mësohet të ketë deklaruar para hetuesve Poli Boriçi, 52-vjeçari i arrestuar për atentatin e dështuar në [Elbasan](#), ku shënjestër ishte 50-vjeçari [Ermir Kërtezi](#).

Sipas deklarimit të tij, motivi i sulmit lidhet me një ngjarje të ndodhur vite më parë. Boriçi ka pretenduar se Kërtezi i kishte plagosur të vëllain dhe se pasojat e asaj ngjarjeje kanë qenë të rënda, deri në paralizimin e tij. Por përballë këtij versioni qëndron deklarimi i personit që ishte shënjestra e sulmit. Kërtezi ka thënë se marrëdhëniet mes tyre ishin normalizuar dhe se dy familjet banonin pranë njëri-tjetrit dhe nuk kanë patur probleme për një dekadë e gjysmë.

Ndërkohë burime nga grupi hetimor bëjnë më dije se janë duke hetuar edhe pista të tjera ndoshta një konflikt i kohëve të fundit mes vetë autorit dhe shënjestrës.

[Sh] .com

LEXO EDHE:

Tentoi të vriste 50-vjeçarin në lokal, Gjykata e Elbasanit lë në burg Poli Boriçin: Doja vetëm ta frikësoja

Ngjarja e pazakontë ndodhi rreth orës 12:40 të së shtunës në lokalin në hyrje të qytetit të Elbasanit, i cili në ato momente ishte plot me klientë.

Nga keto pamje të siguruara nga Report Tv duket objektivi i atentatit, 50-vjeçari Kërtezi, i veshur me bluzë të zezë. Ai fillimisht ndodhej brenda lokalit, kalon mes përmes ambienteve të jashtme të barit, dhe ndalet për pak sekonda jashtë.

Por lëvizjet e tij janë ndjekur nga atentatori [Poli Boriçi](#), i cili ishte në kafe në shoqërinë e bashkëshortes. 52-vjeçari Boriçi çohet menjëherë, nxjerr pistoletën, ia vendos në kokë Kërtezit por arma i bllokohet. Objektivi reagon shpejt, shtyn atentatorin e tij, dhe ka arritur të largohet me shpejtësi. Boriçi e ka ndjekur për pak metra personin që donte ta eliminonte dhe më pas është larguar nga vendi i ngjarjes. Por arratia i ka zgjatur vetëm pak pasi policia ka mundur ta lokalizojë dhe ta arrestojë.

Arma e zjarrit që dyshohet se u përdor në atentat u sekuestrua si provë materiale. Tashmë hetuesit po verifikojnë historinë e konfliktit mes palëve, verifikimin se ç'ka ndodhur 15 vite më parë dhe rrethanat në të cilat marrëdhëniet mes dy familjeve, sipas shënjestrës, ishin normalizuar.

P./J./E.H/Shqiptarja.com

TAG: [Elbasan](#) [tentative vrasje](#) [Poli Boriçi](#) [Ermir Kërtezi](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull?



3.5 / 5 (8 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

Cili është shkaku i konflikteve në Shqipëri?

Politika

Shoqëria

Social media

15 Gusht, 13:45

Lajme të tjera



Liqeni i Degës, një ndër atraksionet natyrore në Belsh! Rama ndan pamjet (VIDEO)

17 Gusht, 08:08



Flakët përfshijnë ullishten në Cërrik, zjarrfikësit neutralizojnë rrezikun pranë banesave (VIDEO)

16 Gusht, 14:16



Tentoi të vriste 50 vjeçarin në Elbasan, pas arrestimit autorit i sekuestrohet edhe pistoleta (VIDEO)

15 Gusht, 17:52




Atentat i dështuar në Elbasan/ Tentoi të vriste 50-vjeçarin në një lokal, por iu bllokua arma! Arrestohet autori (VIDEO)

15 Gusht, 16:06



Shembet dhe del jashtë shtratit kanali vaditës, hapet pas disa orësh qarkullimi në rrugën Elbasan-Cërrik

15 Gusht, 13:20



Banorët denoncuan bllokimin, IKMT liron burimin dhe kanalin e ujitjes së tokave në Mirakë të Librazhdit

14 Gusht, 11:49



Lufta me flakët edhe për faunën, arusha me këlyshin e saj fotografohet në Elbasan

13 Gusht, 20:12



14 vatra zjarri aktive në Shqipëri, Ministria e Mbrojtjes: Situatë e rënduar në Gurë-Lurë të Dibrës dhe Elbasan! Flakët në 'kuroren' e Tiranës vihen nën kontroll

13 Gusht, 18:44



Zjarr në fshatin Lugaxhi të Elbasanit, i afrohet zonave të banuara (VIDEO)

13 Gusht, 14:51



Me pistoletë në çantë, arrestohet 21-vjeçari në Elbasan

13 Gusht, 13:58



Klasa të reja, laboratorë dhe terrene sportive, si po transformohet shkolla 'Mehmet Bajraktari' në Cërrik

13 Gusht, 13:55



Kamioni përplasjet me autobusin me pasagjerë në aksin Elbasan-Peqin, nuk ka të lënduar (VIDEO)

11 Gusht, 13:13

× **[Sh] .com** Lajmi i fundit

'Territorialja'/ Banorët e Divjakës për të 19-ën ditë në protestë, kundërshtojnë bashkimin me Lushnjën: Socialistët e ndershëm ndihnen shumë të fyer me këtë propozim! (VIDEO)

18 Gusht, 22:58



× **[Sh]**
.com Lajmi i fundit



‘Territorialja’/ Banorët e Divjakës për të 19-ën ditë në protestë, kundërshtojnë bashkimin me Lushnjën: Socialistët e ndershëm ndihen shumë të fyer me këtë propozim! (VIDEO)

18 Gusht, 22:58